



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2235 Prot

Lezhë, më 22 / 2 /2023

VENDIM

Nr 11 , datë 21 / 02 /2023

**Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për financimin e ofrimit të shërbimit të përkujdesit social në bashki**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.49/3, datë 11.01.2023 “Transferim fondesh për financim në ofrimin e shërbimit të përkujdesit në bashki”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2023, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2023 në shumën 1,172,000 lekë, fond i cili është akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën 49/3, datë 11.01.2023.

1/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.13, Prog.10430, Kap.01, Art.606 për shumën 1,172,000 lekë. Fondi do të përdoret për:
  - Paga në shumën 542,000 lekë; Sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën 90,000 lekë.
  - Mbështetje ekonomike për fëmijët me aftësi të kufizuara në shumën 500,000 lekë;
  - Për trajnimin e stafit të projektit në shumën 40,000 lekë;

Këto shpenzime do të bëhen për projektin “Tungjatjeta Jetë” gjatë vitin 2023.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



JKB.

Prot 2235/1  
Dt 24.2.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 187/A Prot.

Lezhë, më 24.02.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 9 , datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.11 , datë 21.02.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për një shtesë në buxhetin e bashkisë Lezhë për vitin 2023 dhe përdorim të fondit të akorduar për financimin e ofrimit të shërbimit të përkujdesit social ".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

